

KLSH merr pjesë në workshop-in e organizuar nga ACER dhe WFD për vlerësimin parandalues të korrupsionit në Projektligjin për Investimet e Huaja direkte në Shqipëri

Mbi takimin e zhvilluar më datë 10.12.2024, me temë “Vlerësim parandalues për korrupsionin në Projektligjin për Shqyrtimin e Investimeve të Huaja Direkte në Republikën e Shqipërisë”, projekt i Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD) dhe Qendrës Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER).

Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER) dhe Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD), në kuadër të projektit “Mekanizmat Kombëtarë të Screening”, më datë 10.12.2024, organizuan workshop-in me temë “Vlerësim parandalues për korrupsionin në Projektligjin për Shqyrtimin e Investimeve të Huaja Direkte në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim ndërtimin e një sistemi adekuat të “screening”-ut të investimeve të huaja direkte, duke synuar minimizimin e rreziqeve potenciale për ekonominë kombëtare, sigurinë dhe rendin publik në vend.

Organizatori i këtij takimi, z. Zef Preçi, Drejtor Ekzekutiv i ACER, diskutoi mbi rëndësinë e uljes së rreziqeve korruptive të legjislacionit, si një masë e rëndësishme profilaktike, si dhe trajtoi konceptin dhe dimensionin e Sigurisë Kombëtare; konceptin e lidhjes midis IHD dhe sigurisë; shqetësimet për investimet e huaja, si dhe nevojat dhe parakushtet për mekanizmin funksional të "Screening".

Znj. Laureta Memo, Menaxhere Programi WFD Shqipëri, theksoi bashkëpunimin me ACER për zbatimin e vlerësimit parandalues për korrupsionin si një aspekt thelbësor i përmirësimit të rolit mbikëqyrës të Kuvendit dhe garantimit të mbrojtjes së interesit publik.

Nga ekspertët znj. Brunilda Kosta, Eksperte (Universiteti i Tiranës, Fakulteti Ekonomik) dhe znj. Zyhrada Kongoli, Eksperte (Freelance dhe konsulente ligjore), u diskutuan çështje teknike të Projektligjit “Për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte në Republikën e Shqipërisë”.

Deputetja e Kuvendit të Shqipërisë Znj. Jorida Tabaku, iniciuese e këtij projektligji, theksoi jo vetëm rëndësinë e tij, por edhe të diskutimit publik me të gjitha grupet e interesit, me qëllim finalizimin e një ligji të dobishëm që do t'i shërbejë interesave publike dhe sigurisë kombëtare.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të Ambasadës Britanike në Tiranë, përfaqësues të Dhomës Amerikane dhe Gjermane të Tregtisë, etj.

Kontrolli i Lartë i Shtetit në këtë takim u përfaqësua nga znj. Brunilda Zeneli.